Vendim nr.319, datë 07.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 07.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (F) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATOS DUSHA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 6, datë 16.01.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 46 (87-2023-250), datë 07.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2026-265, datë 26.02.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 20 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 e vijues të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 28 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi së bashku me disa persona të tjerë janë proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) për veprën penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 298, paragrafi i parë, dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal (*KP*). Fakti penal lidhej me ngjarjen e datës 08.01.2021, kur në brigjet e Vlorës janë lokalizuar rreth 55 shtetas të huaj, me origjinë siriane, iraniane dhe egjiptiane, të cilët synonin të kalonin në mënyrë të paligjshme kufirin shqiptar. Të nesërmen, më 09.01.2021, gjatë kontrollit të ushtruar në një banesë private trekatëshe në Tiranë, në pronësi të kërkuesit, e cila përdorej si *hostel*, janë gjetur 9 shtetas sirianë. Sipas të dhënave të policisë, këta shtetas kishin ndjekur itinerare të ngjashme migratore, duke udhëtuar nga Siria në Turqi dhe më pas drejt Greqisë, prej nga kishin hyrë në këmbë në territorin shqiptar, me synimin për të kaluar në Itali ose në vende të tjera evropiane, si Gjermania dhe Norvegjia. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, e cila është pranuar nga gjyqtari i seancës paraprake.

2. Gjatë seancës paraprake, kërkuesi dhe mbrojtësi i tij kanë paraqitur kërkesë për gjykimin e shkurtuar të çështjes. Kjo kërkesë është pranuar gjatë gjykimit nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me arsyetimin se ajo ishte paraqitur në kohën e duhur nga subjektet e legjitimuara dhe se çështja mund të zgjidhej në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet e fashikullit të hetimit paraprak, për sa kohë nuk ishin konstatuar akte absolutisht të pavlefshme.

3. Në përfundim të gjykimit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 6, datë 16.01.2023, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit vetëm për veprën penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve, të kryer në bashkëpunim të thjeshtë, të parashikuar nga neni 298, paragrafi i tretë, i KP-së, dhe, pas uljes së dënimit me 1/3-ën, për shkak të gjykimit të shkurtuar, e ka dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim. Gjithashtu, bazuar në nenin 59 të KP-së, gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e kërkuesit në provë për 3 vjet.

4. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin

nr. 46 (87-2023-250), datë 07.11.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-265 datë 26.02.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij.

5. Në datën 11.06.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.06.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara i janë cenuar:

6.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi nuk është provuar kryerja e ndonjë veprimtarie të paligjshme nga ana e tij. *Hosteli* në pronësi të tij ushtron aktivitet të ligjshëm dhe është i regjistruar në platformat ndërkombëtare *Airbnb* dhe *Booking*. Veprimet e shtetasve të huaj që kanë qëndruar në *hostel* nuk mund t'i atribuohen atij dhe, në çdo rast, ato përbëjnë kundërvajtje penale, për të cilat këta shtetas gëzojnë mbrojtje sipas akteve ndërkombëtare dhe nuk i nënshtrohen ndjekjes ose dënimit penal në vendin tonë. Veprimet nuk lidhen me krimin e organizuar ose trafikimin e qenieve njerëzore për qëllime prostitucioni, skllavërimi apo pune të detyruar. Për rrjedhojë, fakti për të cilin është dënuar nuk përbën krim ose ndonjë vepër tjetër penale. Dënimi i kërkuesit është mbështetur në dëshmi të rreme dhe në një akuzë të montuar.

6.2. *Parimi ne bis in idem,* i garantuar nga neni 34 i Kushtetutës, pasi ai është proceduar penalisht më parë për të njëjtën akuzë dhe ka marrë vendim pafajësie nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm Vlorë.

6.3. *Liria personale,* e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi ndaj tij është caktuar masa e sigurimit e arrestit në burg, duke u akuzuar për krim të organizuar dhe me një dispozitë që parashikon burgim të përjetshëm. Pas disa muajve gjykata e ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të arrestit në shtëpi, sepse kërkuesit i rrezikohej jeta për shkak të gjendjes shëndetësore. Në përfundim ai ka marrë dënim me kusht që vërteton se arrestimi ka qenë i paligjshëm.

6.4. *E drejta për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues,* e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, pasi ndaj tij është ushtruar dhunë psikologjike, si pasojë e së cilës është detyruar të heqë dorë nga privilegji kundër

vetinkriminimit, i garantuar nga neni 32 i Kushtetutës. Deklarimet e dhëna në këto rrethana janë përdorur si prova kundër tij, ndonëse fakti, për të cilin është proceduar, nuk përbën as krim të organizuar dhe as ndonjë vepër tjetër penale.

6.5. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.5.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen me pjesëmarrjen e palëve ndonëse në rekurs ishte ngritur pretendimi se vepra penale e kontrabandës së qenieve njerëzore nuk përbën krim, por kundërvajtje penale dhe fakti për të cilin ai është akuzuar nuk përbën as krim, as kundërvajtje penale. Dënimi me burgim është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, si dhe përbën dënim mizor për nga ashpërsia.

6.5.2. *E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi kërkuesi nuk është dëgjuar nga një gjykatë kompetente. Janë bashkuar qëllimisht në mënyrë mekanike 7 procedime që u përkasin rretheve të ndryshme gjyqësore dhe që nuk kanë asnjë lidhje me njëri -tjetrin, që akuza të përmbajë veprën penale të organizatës kriminale dhe t'i kalojë për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme.

6.5.3. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi prokuroria dhe gjykata kanë vepruar në mënyrë të padrejtë ndaj tij, duke cenuar një sërë të drejtash dhe garancish procedurale. Ai është arrestuar dhe mbajtur në paraburgim në mënyrë të paligjshme, pa u informuar në kohë për shkaqet e arrestimit dhe natyrën e akuzës, si dhe pa iu garantuar e drejta për ndihmë juridike, për t'u paraqitur përpara gjykatës dhe për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit dhe të paraburgimit. Gjatë paraburgimit është trajtuar në mënyrë çnjerëzore, është mbajtur në izolim dhe i është kufizuar komunikimi me familjarët, avokatët dhe persona të tjerë. Gjatë gjykimit nuk i janë garantuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për një seancë publike, gjykimi nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, si dhe koha dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes. I është cenuar e drejta për t'u mbrojtur vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi, për të pyetur dëshmitarët dhe për t'u asistuar nga një përkthyes, si dhe e drejta për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme. Atij i është shkelur privilegji kundër vetinkriminimit, ndalimi i zbatimit prapaveprues të ligjit penal dhe parimi *ne bis in idem*, si dhe i janë cenuar të drejtat e ankimit dhe e kompensimit për gabimet gjyqësore.

6.5.4. *Parimi i ligjshmërisë*, pasi ai është detyruar të kërkojë gjykimin e shkurtuar për të shmangur një dënim të ashpër, si pasojë e mënyrës së zhvillimit të procedimit penal nga organi i akuzës. Gjykimi i shkurtuar i ka pamundësuar *de facto* kundërshtimin e provave të administruara, të cilat janë fabrikuar nga prokuroria dhe Policia Gjyqësore, si dhe ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, përfshirë pyetjen e dëshmitarëve, verifikimin e provave dhe kundërshtimin e kërkesave të prokurorit. Kërkesa për gjykim të shkurtuar ka qenë rezultat i shtrëngimit dhe, për rrjedhojë, është juridikisht e pavlefshme, duke sjellë pavlefshmërinë e të gjithë procesit gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit.

6.5.5. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar gabim ligjin material dhe procedural. Prokuroria ka dështuar të zbulojë krimin dhe autorët. Në përfundim të gjykimit, gjykata e pushoi akuzën për krim të organizuar dhe jashtë kompetencës së saj e ka deklaruar fajtor për kontrabandë të qenieve njerëzore dhe për bashkëpunim të thjeshtë, por pa përcaktuar dhe individualizuar personin konkret, me të cilin është bërë bashkëpunimi. Vendimi ka qenë i ashpër dhe ligji material ka qenë i gabuar.

6.6. *E drejta për dëmshpërblim për burgim të padrejtë*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi procesi ka qenë tërësisht i manipuluar, i falsifikuar, në shkelje të hapur me të drejtat e njeriut dhe vendimet e dhëna duhet të deklarohen të pavlefshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

7. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e

reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

9. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në analizimin e kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive,* që lidhet me përdorimin e mjeteve juridike në dispozicion të kërkuesit, si dhe të legjitimimit *ratione materiae,* që ka të bëjë me natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura.

10. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në aspektin formal, kërkuesi duhet t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet asaj, ndërsa, në aspektin substancial, duhet t'i ketë parashtruar më parë, të paktën në substancë, të gjitha pretendimet që ngre në gjykimin kushtetues, përpara asaj gjykate që ka pasur realisht kompetencën dhe mundësinë për të riparuar shkeljen e pretenduar (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Nga ana tjetër, ai kërkon që vetë individi të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur në kohë, përpara këtyre organeve dhe gjykatave, kërkesat, kundërshtimet ose ankimet që lidhen me rrethanat mbi të cilat mbështet pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *lirisë personale*, duke parashtruar se ndaj tij janë caktuar padrejtësisht masat e sigurimit të arrestit në burg dhe, më pas, të arrestit në shtëpi, ndërkohë që në përfundim të procesit është dënuar me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim, çka, sipas tij, dëshmon paligjshmërinë e arrestimit. Gjithashtu, ai ka pretenduar cenimin e *ndalimit për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues*, për shkak të dhunës psikologjike të ushtruar ndaj tij, e cila e ka detyruar të heqë dorë nga privilegji kundër vetinkriminimit. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të*

një sërë garancish procedurale, që lidhen me njohjen e shkaqeve të arrestimit dhe të akuzës, ndihmën juridike, komunikimin me familjarët dhe mbrojtësin, kundërshtimin e masave të privimit të lirisë, kushtet humane të paraburgimit, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për një gjykim publik nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, kohën dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, gjykimin pa vonesa të panevojshme, pyetjen e dëshmitarëve dhe ndihmën e interpretit. Gjithashtu, ka pretenduar cenimin e *parimit të ligjshmërisë*, bazuar në argumentin se është detyruar të kërkojë gjykim të shkurtuar për të shmangur një ndëshkim të rëndë, si pasojë e mënyrës së zhvillimit të procedimit nga organi i akuzës, duke u vendosur kështu *de facto* në pamundësi për të kundërshtuar provat që, sipas tij, janë fabrikuar nga prokuroria dhe Policia Gjyqësore. Së fundi, ai ka pretenduar cenimin e *së drejtës për dëmshpërblim për burgim të padrejtë*, me argumentin se procesi penal ndaj tij ka qenë i manipuluar, i falsifikuar dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut.

12. Nga aktet që i janë bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk rezulton që t'i ketë ngritur pretendimet e mësipërme, së bashku me argumentet në mbështetje të tyre, në mjetet e ankimit të paraqitura përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, përkatësisht në apel dhe në rekurs. Ai i ka parashtruar ato për herë të parë përpara Gjykatës, pa u dhënë më parë gjykatave të zakonshme mundësinë për t'i shqyrtuar dhe për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këto pretendime kërkuesi nuk ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, ndaj për këtë shkak ato nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Lidhur me pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me cenimin e parimeve të *prezumimit të pafajësisë* dhe *ne bis in idem*, si dhe së drejtës për *proces të rregullt ligjor* në disa aspekte (aksesi, gjykatë e caktuar me ligj dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor), Kolegji çmon t'i verifikojë në këndvështrim të legjitimimit *ratione materiae*.

14. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, kërkuesi ka parashtruar se *hosteli* është regjistruar në platformat ndërkombëtare *Airbnb* dhe *Booking* dhe nuk është vërtetuar asgjë e paligjshme në veprimtarinë e biznesit. Aktiviteti është plotësisht ligjor dhe veprimet e paligjshme nuk janë kryer prej tij, por prej personave që janë bujtës te *hosteli*. Fakti penal për të cilin është dënuar nuk përbën as krim dhe as vepër tjetër penale. Po kështu, është përdorur dëshmi e rremë dhe akuzë e montuar.

15. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata

vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji do të verifikojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë individualizuar në mënyrë të mjaftueshme faktet penale dhe përgjegjësinë e kërkuesit, kanë identifikuar dhe vlerësuar provat mbi të cilat kanë mbështetur përfundimet e tyre, si dhe nëse arsyetimi i tyre mbështet konkluzionin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

17. Paraprakisht, Kolegji vë në dukje se çështja e kërkuesit, mbi bazën e kërkesës së tij, është shqyrtuar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar. Përmes zgjedhjes së kësaj procedure, ai ka pranuar që çështja të zgjidhej në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet e hetimit paraprak, duke hequr dorë nga administrimi i provave sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm dhe nga mundësia për të paraqitur prova e për të thirrur dëshmitarë. Gjithashtu, nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij nuk kanë ngritur pretendime mbi gjendjen e akteve të administruara në fashikullin e hetimeve (*shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqja 25*).

18. Për sa i takon themelit të akuzës, Prokuroria e Posaçme e ka akuzuar kërkuesin, së bashku me 17 persona të tjerë, për veprat penale të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, dhe të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 298, paragrafi i parë, 333/a, paragrafi i parë dhe 334, paragrafi i parë, të KP-së. Sipas prokurorisë, kryerja e këtyre veprave penale provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm nga procesverbalet e këqyrjes së telefonave të personave nën hetim, përfshirë kërkuesin, si dhe nga kontrolli i banesës së tij trekatëshe, e cila shërbente si *hostel*. Gjatë marrjes në pyetje, kërkuesi ka deklaruar se ushtronte veprimtari hotelerie, kundrejt një tarife prej 7 eurosh, duke mohuar lidhjet me persona që synonin dërgimin e emigrantëve drejt Italisë ose vendeve të tjera. Megjithatë, sipas prokurorisë, nga këqyrja e telefonit të tij kishin rezultuar komunikime të shpeshta, gjatë periudhës 17.11.2020–08.01.2021, për sigurimin e akomodimit të emigrantëve në *hostelin* e tij, që dëshmonin se ai kishte dijeni për hyrjen e shtetasve të huaj në territorin shqiptar dhe garantonte strehimin e tyre.

19. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kërkuesi, përmes kontakteve me shtetas të ndryshëm të huaj, u kishte siguruar emigrantëve strehimin e tyre në *hostelin* ku ushtronte veprimtarinë. Megjithatë, gjykata ka çmuar se veprimet e tij ishin kryer në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, pasi nuk provohej që ai të kishte dijeni se po kontribuonte në veprimtarinë e një grupi të strukturuar kriminal. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 375, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), gjykata ka ndryshuar cilësimin juridik të veprimeve të kërkuesit, duke e deklaruar fajtor vetëm për veprën penale të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 298, paragrafi i tretë, i KP-së. Në përfundim, ajo e ka dënuar me 3 vjet e 4 muaj burgim, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien e tij në periudhë prove për 3 vjet.

20. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, ndonëse kjo e fundit e ka vlerësuar të gabuar cilësimin juridik të veprimeve të kërkuesit. Sipas gjykatës së apelit, veprimet e tij ishin kryer për qëllime fitimi dhe në kushtet e bashkëpunimit të veçantë, ndaj duhej të cilësoheshin sipas nenit 298, paragrafi i dytë, të KP-së, që parashikon dënimin me burgim nga 3 vjet deri në 7 vjet kur ndihma jepet për qëllime fitimi, në lidhje me nenin 28, paragrafi i katërt, të KP-së. Megjithatë, duke qenë se ankimi ishte paraqitur vetëm nga kërkuesi dhe cilësimi i saktë juridik do të rëndonte pozitën e tij, gjykata e apelit, në zbatim të nenit 425, pika 3, të KPP-së, ka vlerësuar se nuk mund ta ndryshonte atë në dëm të atij.

21. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke lënë të pacenuar vendimin e gjykatës së apelit. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar qartë se kërkuesi, përmes komunikimeve telefonike me kontakte të ndryshme të huaja, u ka siguruar emigrantëve strehimin e tyre në *hostelin* ku ushtronte veprimtarinë, duke konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 298, paragrafi i tretë, i KP-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ndryshimi i cilësimit juridik të akuzës nga gjykata e shkallës së parë ka lehtësuar pozitën e kërkuesit, pa cenuar konstatimin e fajësisë së tij për faktin penal të provuar. Po kështu, ajo ka çmuar se argumentet e kërkuesit, sipas të cilave, si hotelier, nuk kishte detyrimin të hetonte qëllimet e bujtësve, këta të fundit dispononinn dokumente të rregullta identifikimi, nuk u ishte kërkuar pagesë përtej tarifës zyrtare dhe veprimet e tij nuk ishin të kundërligjshme, synonin në thelb rivlerësimin e fakteve dhe të provave, çka dilte jashtë juridiksionit të saj si gjykatë ligji. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka theksuar se gjykatat e faktit, bazuar në komunikimet në *WhatsApp* me kontakte të regjistruara si "Muas", "Boss" dhe të tjerë, kanë arsyetuar se kërkuesi nuk ka ushtruar thjesht veprimtari hotelerie, por ka qenë në dijeni të natyrës së paligjshme të qëndrimit të shtetasve të huaj dhe ka

garantuar strehimin e tyre në funksion të veprimtarisë së kalimit të paligjshëm të kufirit (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 71.3. dhe 71.4*.)

22. Për sa më lart, Kolegji çmon se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shqyrtuar në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes dhe provat e administruara, duke individualizuar përgjegjësinë penale të tij përmes përcaktimit të veprimeve konkrete, rolit dhe kontributit në kryerjen e veprës penale. Ato kanë analizuar komunikimet e kërkuesit dhe, mbi bazën e vlerësimit të provave në tërësi, kanë arritur në përfundimin për fajësinë e tij për veprën penale të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve. Nga ana tjetër, duke vlerësuar dyshimet në favor të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë ka çmuar të paprovuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen e veprës penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, duke ndryshuar cilësimin juridik të akuzës në favor të tij. Po kështu, gjykata e apelit, ndonëse ka vlerësuar se veprimet e kërkuesit duhej të cilësoheshin si dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufijve për qëllime fitimi dhe në kushtet e bashkëpunimit të veçantë, nuk ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke respektuar parimin e mosrëndimit të pozitës së kërkuesit. Ndërsa Gjykata e Lartë ka ushtruar kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta, brenda kufijve të juridiksionit të saj si gjykatë ligji. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se gjykatat kanë shqyrtuar provat, pretendimet dhe argumentet e kërkuesit, kanë vlerësuar dyshimet në favor të tij dhe nuk rezulton të kenë mbështetur përfundimet e tyre në paragjykime për fajësinë e tij. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

23. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit *ne bis in idem*, kërkuesi ka parashtruar se është deklaruar fajtor mbi bazën e një akuze të montuar dhe të mbështetur në prova të rreme, ndonëse për të njëjtën akuzë ishte deklaruar i pafajshëm nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm, me vendimin nr. 204, datë 26.04.2022.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se parimi *ne bis in idem*, i garantuar nga neni 34 i Kushtetutës, ndalon ndjekjen ose dënimin penal të një individi për të njëjtën vepër penale për të cilën ai është deklaruar më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Në këtë kuptim, kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjelljeje ose fakti që përbën bazën e veprës penale për të cilën individi është gjykuar më parë, duke marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të saj *(shih vendimet nr. 11, datë 13.03.2025; nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuesit është shqyrtuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat e kanë vlerësuar atë të pabazuar. Në këtë

drejtim, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se, ndonëse kërkuesi ka pretenduar se me vendimin nr. 204, datë 26.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ishte deklaruar i pafajshëm për faktin penal të datës 08.01.2021, nuk rezultonte e provuar që ky vendim të kishte marrë formë të prerë. Gjithashtu, ajo ka vënë në dukje se kërkuesi ka pranuar gjykimin e shkurtuar, që nënkuptonte shqyrtimin e çështjes në gjendjen e akteve të hetimit paraprak, në të cilat nuk gjendej vendimi në fjalë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka pasur mundësi të verifikonte dhe të vlerësonte efektet e tij. Sipas gjykatës së apelit, në kushtet kur ishin dhënë vendime nga dy gjykata të ndryshme, situata duhej të zgjidhej nëpërmjet mekanizmit të parashikuar nga neni 474 i KPP-së, sipas të cilit, kur ndaj të njëjtit person janë dhënë disa vendime për të njëjtin fakt, urdhërohet ekzekutimi i vendimit që përmban dënimin më të lehtë dhe vendimet e tjera deklarohen të pazbatueshme (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqja 60*).

26. Edhe Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim, duke argumentuar se arsyetimi i gjykatave të faktit është në përputhje me dispozitat procedurale në fuqi. Parimi *ne bis in idem* i sanksionuar nga neni 7 i KPP-së, në përputhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, kërkon si kusht paraprak ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për të njëjtin fakt penal. Sipas saj, në mungesë të plotësimit të këtij kushti, nuk mund të pretendohet cenimi i këtij parimi (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafi 71.1.*).

27. Kolegji vëren se kërkuesi i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues individual dy vendime të gjykatës së shkallës së parë Vlorë: (i) vendimin nr. 204, datë 26.04.2022, me të cilin është deklaruar i pafajshëm, por që nuk përmban shënim për marrjen e formës së prerë; (ii) vendimin nr. 146, datë 13.03.2024, për pushimin e gjykimit ndaj tij, në të cilin referohet një vendim i mëparshëm pafajësie, nr. 168, datë 17.01.2022, i prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 20, datë 26.01.2023.

28. Nga këqyrja e akteve të dosjes gjyqësore, Kolegji konstaton se kërkuesi është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit me vendimin nr. 204, datë 26.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Megjithatë, ndaj këtij vendimi, në pjesën që dispononte pafajësinë e kërkuesit, Prokuroria e Vlorës ka ushtruar ankim në datën 09.05.2022, duke kërkuar deklarimin e tij fajtor. Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 20, datë 26.01.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Në vendimin e gjykatës së apelit, atributet e vendimit të gjykatës së shkallës së parë janë pasqyruar gabimisht si nr. 168, datë 17.01.2022, gabim i cili është përsëritur edhe në vendimin nr. 146, datë 13.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Me këtë të fundit, gjykata ka vendosur pushimin e akuzës, në

zbatim të nenit 328, pika 1, shkronja "e", të KPP-së, për shkak se kërkuesi ishte gjykuar tashmë për të njëjtin fakt penal me vendim të formës së prerë nga gjykata e posaçme. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se, ndonëse kërkuesi ishte deklaruar fillimisht i pafajshëm nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm, ky vendim nuk kishte marrë formë të prerë, pasi ishte ankimuar rregullisht nga prokuroria dhe ishte prishur nga gjykata e apelit. Për rrjedhojë, në mungesë të një vendimi të mëparshëm përfundimtar pafajësie ose dënimi për të njëjtin fakt penal, nuk rezulton të jenë përmbushur kushtet për zbatimin e parimit *ne bis in idem* në procesin gjyqësor të kundërshtuar në ankimin kushtetues individual, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e këtij parimi është haptazi i pabazuar.

29. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë*, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ndonëse në rekurs kishte ngritur pretendime për cilësimin juridik të veprës penale, duke argumentuar se kontrabanda e qenieve njerëzore nuk përbën krim, por kundërvajtje penale, si dhe se fakti për të cilin akuzohej nuk përbënte as krim, as kundërvajtje penale.

30. Gjykata ka pohuar se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore me praninë e palëve u përket kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kolegji i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit, ka kompetencën të vlerësojë nëse shkaqet e rekursit përmbushin kërkesat ligjore dhe, nëse arrin në përfundimin se ato objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, të vendosë mospranimin e rekursit, në përputhje me parashikimet ligjore (*shih vendimet nr. 55, datë 10.10.2025; nr. 17, datë 10.04.2025; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit shkaqet e rekursit të kërkuesit dhe ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se nuk rezultonin shkelje të ligjit material ose procedural penal që të justifikonin shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në këtë drejtim, Kolegji çmon se shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, në vend të seancës gjyqësore me praninë e palëve, nuk përbën në vetvete cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencën e saj në përputhje me rregullat procedurale dhe nuk rezulton që vendimmarrja e saj të ketë qenë arbitrare ose haptazi e paarsyeshme. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është haptazi i pabazuar.

32. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuesi ka parashtruar se çështja e tij nuk është shqyrtuar nga një gjykatë

kompetente, pasi 7 procedime penale, që u përkisnin rretheve të ndryshme gjyqësore dhe nuk kishin lidhje me njëri-tjetrin, janë bashkuar qëllimisht dhe në mënyrë mekanike, me synimin për të përfshirë në akuzë veprën penale të organizatës kriminale dhe për ta kaluar çështjen në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme.

33. Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nënkupton që çështja të shqyrtohet nga gjykata që ka juridiksion dhe kompetencë për ta gjykuar atë, kompetencë e cila duhet t'i jetë atribuar me ligj (*shih vendimet nr. 55, datë 07.11.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Kolegji konstaton se ky pretendim është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka vlerësuar të pabazuar, duke arsyetuar se kompetenca lëndore e gjykatës përcaktohet në bazë të akuzës së ngritur në momentin e paraqitjes së çështjes për gjykim dhe jo në varësi të përfundimit të gjykimit për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se Prokuroria e Posaçme e kishte dërguar kërkuesin për gjykim, ndër të tjera, edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 333/a i KP-së, e cila përfshihet në kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme. Fakti që kërkuesi është deklaruar i pafajshëm për këtë vepër penale në përfundim të gjykimit nuk sjell humbjen në mënyrë prapavepruese të kompetencës lëndore të gjykatës, pasi një interpretim i tillë do të cenonte sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e gjykatës kompetente. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka çmuar se kompetenca lëndore duhet të vlerësohet në momentin e vënies në lëvizje të gjykatës dhe jo *post factum*, në varësi të rezultatit të gjykimit, ndaj nuk konstatohen shkaqe të pavlefshmërisë absolute sipas nenit 128 të KPP-së (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafi 71.2.*).

35. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, çështja e tij është shqyrtuar nga një gjykatë kompetente dhe e caktuar me ligj. Sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, kompetenca lëndore e gjykatës përcaktohet nga nenet 74 - 82 të KKP-së, mbi bazën e akuzës së ngritur nga prokuroria në momentin e dërgimit të çështjes për gjykim, e cila, në rastin konkret, përfshinte edhe veprën penale të grupit të strukturuar kriminal, që i përkiste kompetencës së gjykatave të posaçme. Nga ana tjetër, ligji parashikon garancitë e nevojshme procedurale që akuza e ngritur nga prokuroria t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor dhe, në varësi të provave të shqyrtuara gjatë gjykimit, të ndryshohet ose të rrëzohet, sikurse ka ndodhur edhe në rastin e kërkuesit. Për rrjedhojë, fakti që gjykata nuk e ka gjetur të provuar akuzën për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal nuk vë në dyshim kompetencën e saj të përcaktuar sipas ligjit në momentin e fillimit të gjykimit. Gjithashtu, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë i ka dhënë një përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi, pa rezultuar që interpretimi i saj të jetë arbitrar ose haptazi

i paarsyeshëm. Në këto rrethana, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

36. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka lejuar shkelje të rënda procedurale dhe zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, ndërkohë që prokuroria ka dështuar në zbulimin e veprës penale dhe të autorëve të saj. Sipas tij, vendimi i dënimit është i ashpër dhe i mbështetur në një zbatim të gabuar të ligjit material.

37. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se arsyetimi i vendimit gjyqësor është element thelbësor i një vendimi të drejtë, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe u mundëson kundërshtimin e vendimmarrjes. Shkalla e arsyetimit ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të pasqyrohen shkaqet e rekursit dhe arsyetimi të shprehë, në thelb, shkaqet e mospranimit të tij gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë shqyrtuar pretendimet e kërkuesit lidhur me zbatimin e ligjit material dhe procedural, duke dhënë përgjigje të mbështetura në provat e administruara dhe në dispozitat ligjore të zbatueshme. Në veçanti, ato kanë argumentuar përfundimin për fajësinë e kërkuesit për veprën penale të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve, ndërsa kanë vlerësuar të paprovuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen e kësaj vepre në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Gjithashtu, gjykatat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve për mungesën e kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme dhe cenimin e parimit *ne bis in idem*, duke sqaruar se vendimi i mëparshëm i pafajësisë, i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk ka marrë formë të prerë. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka pasqyruar rrethanat e çështjes dhe shkaqet e rekursit, duke parashtruar arsyet për mospranimin e tij, në përputhje me natyrën dhe kufijtë e shqyrtimit në dhomën e këshillimit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se gjykatat u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara çështjeve thelbësore të ngritura nga kërkuesi, pa rezultuar që arsyetimi i vendimeve të tyre të jetë arbitrar ose haptazi i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

39. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.